



## **Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike përgjatë vitit 2016**

Në datën 26 Janar 2017, Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja si dhe Shoqërive Publike, zhvilloi në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, analizën vjetore të vitit 2016, me temë “Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, përgjatë vitit 2016”.



Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç audituesve të departamentit, morën pjesë dhe znj. Luljeta Nano Sekretare e Përgjithshme e KLSH, Prof. Dr. Dhori Kule Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kyetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe njëkohësisht ekspert i jashtëm në KLSH, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe gazetarët, z. Artur Cani, z. Brenton Kotorri, z. Elton Qyno, z. Fatos Çoçoli dhe z. Kliti Topalli, anëtarë të stafit akademik të Fakultetit të Ekonomisë, si dhe të ftuarit z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, znj. Miranda Haxhia dhe znj. Ina Sokoli, audituese në KLSH.

Analiza vjetore filloi me fjalën përshëndetëse të Sekretares së Përgjithshme znj. Luljeta Nano dhe me fjalën përshëndetëse të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë Prof. Dr. Dhori Kule. Analizën e departamentit e përshëndetën edhe Prof. Dr. Jorgji Bollano Kyetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, z. Artur Cani dhe z. Brenton Kotorri, pjesëtarë të shoqërisë civile.



Më pas fjalën e mori Drejtorja e Departamentit, znj. Albana Agolli, e cila vijoi me prezantimin përmbledhës për punën audituese gjatë vitit 2016; arritjet, mangësitë dhe sfidat kryesore të departamentit. Gjatë prezantimit të punës audituese të departamentit për vitin 2016, znj. Agolli theksoi se analiza e performancës, zhvillohet nën prizmin e Temës së Dytë Qendrore të Kongresit INCOSAI XXII, të INTOSAI-t, dhe pikërisht të profesionalizmit në auditim dhe se çfarë mund të nxisë besueshmërinë e raporteve tona të auditimit. Kjo analizë synon të japë një panoramë të përgjithshme të rezultateve, arritjeve kryesore në funksion të përmbushjes së objektivave të Departamentit si dhe ato institucionale, por edhe në funksion të rritjes së figurës së audituesit të Departamentit dhe të besueshmërisë në kapacitetet dhe profesionalizmin e tij. Kjo qasje analitike na jap mundësinë, për t'u njohur më mirë me të metat dhe dobësitë tona, për të identifikuar dhe analizuar risqet, duke i vlerësuar ato me përgjegjshmërinë më të lartë për zbatimin e tyre dhe përmirësimin e punës audituese në të ardhmen.

Arritjet e departamentit deri tani dhe kryesisht ato gjatë vitit 2016, janë rezultat i punës dhe angazhimit të çdo audituesi, si dhe i përpjekjeve të tyre për përmirësim të vazhdueshëm.

Duke synuar një pamje gjithëpërfshirëse, treguesit janë pasqyruar jo vetëm në nivelet e arritura përgjatë vitit 2016, por janë vendosur në raporte krahasimore me treguesit e veprimtarisë së Departamentit gjatë viteve të mëparshme (periudhë 4 vjeçare), çka mundëson një informacion më të plotë të punës së Departamentit duke treguar ritmet e rritjes dhe zhvillimit.

Për vitin 2016, Departamenti, nga 24 auditime të planifikuara për evadim, sipas Programit të miratuar të auditimeve, ka ushtruar dhe evaduar 26 auditime ose në masën 108%, nga të cilat 21 auditime përputhshmërie dhe rregullshmërie financiare (16 auditime në shoqëritë publike përfshirë institucione, autoritete dhe 5 auditime në fushën e projekteve), 1 auditim përputhshmërie, 1 auditim financiar dhe 3 auditime tematike.

Nga analiza e zbulimeve për 26 auditimet e evaduara, gjatë vitit 2016, janë evidentuar mospërputhje të veprimtarisë me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator të shoqëruara me **dëm ekonomik në vlerën 17,823,178 mijë lekë rekomanduar 100% për zhdëmtim**, dhe të

**ardhura të munguara apo shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në vlerën 25,255,563 mijë lekë.**

Rezultatet nga auditimi i 26 subjekteve të audituara, kanë evidentuar nevojën e rekomandimit të masave për përmirësimin e gjendjes, për mirëmenaxhimin e aktivitetit nëpërmjet masave organizative, për parandalimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës në keqadministrimin e fondeve dhe pasurisë publike, nëpërmjet dhënies së masave administrative dhe disiplinore, si dhe ka raste të dërgimit në organin e Prokurorisë, kur janë konstatuar shpërdorime të detyrës. Konkretisht për vitin 2016, janë rekomanduar 558 masa organizative, 188 masa për shpërblim dëmi në vlerën 17,823,178 mijë lekë, 256 masa disiplinore, 23 masa administrative, si dhe janë dërguar në organin e prokurorisë 5 kallëzime penale, për 5 drejtues apo administrator të shoqërive dhe enteve si dhe 1 indicie.

Si rezultat i impenjimit, rritjes së përgjegjshmërisë së audituesve, organizimit dhe forcimit të punës në grup, vihet re se është rritur efienca në punën e departamentit duke patur trend në rritje për realizimin e objektivave, duke kryer kryesisht auditime të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, auditime tematike, është zhvilluar 1 auditim përputhshmërie (pilot) bazuar në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe 2 auditime performance në bashkëpunim me Departamentin e Auditimit të Performancës.

Nga 26 auditimet e realizuara veçojmë **auditimet me gjetje më të larta:**

I. Në fushën e shoqërive publike:

1. Albpetrol SHA, vlera e demit ekonomik 15,108,088 mije lekë,
2. KESH SHA, vlera e demit ekonomik 391,808 mije lekë,
3. Autoriteti Portual Durrës, vlera e demit ekonomik 217,142 mije lekë.

II. Në fushën e projekteve me financime të huaja:

1. ARRSH Projekti “Ndërtimi i segmentit “By-pass Fier-Vlorë”, vlera e demit ekonomik 1,322,926 mije lekë,
2. ARRSH Projekti “Ndërtimi i aksit Tiranë-Elbasan”, vlera e demit ekonomik 306,169 mije lekë,
3. Ministria e Shëndetësisë Projekti “Shëndetësia elektronike në Shqipëri, regjistri mbarëkombëtar i shëndetësisë elektronike” vlera e demit ekonomik 243,834 mije lekë.

Gjithashtu përmendim auditimet e **vlerësuara dobët**, si Ndërmarrja “Trajtimi i Studentit nr. 3” SHA Tiranë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Lezhë, Spitali Rajonal Fier dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Një nga treguesit kryesorë të performancës së auditimeve, është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Për përmirësimin e punës në të ardhmen nga departamenti ynë për vitin 2016 janë dhënë gjithsej **1025** rekomandime në **26** auditime të evaduara. Kanë kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve **20** subjekte (të cilat janë përfshirë në auditimin e kryer për zbatimin e rekomandimeve), jemi në pritje të përgjigjes nga **5 subjekte**, të cilat janë brenda afatit ligjor për kthimin e përgjigjes (pa përfshirë auditimin për zbatimin e rekomandimeve).

Masa organizative janë rekomanduar gjithsej **558 masa**, nga të cilat janë pranuar 419 masa ose në masën 98.8%, si dhe janë realizuar plotësisht, pjesërisht, ose në proces realizimi **396** të tilla ose në masën **93%**, pa llogaritur 5 subjekte të tjera që janë brenda afatit të kthimit të përgjigjes.

Për zhdëmtimin e demit ekonomik të konstatuar në shumën **17,823,178 mijë lekë**, vlerë e cila është kërkuar 100 % për zhdëmtim. Nga kjo vlerë, janë pranuar dhe kanë nisur procedurat për kthimin e shumave prej 1,224,353 mijë lekë ose në masën **93.8%**, kurse nga verifikimi nga KLSH në 20 subjekte realizimi paraqitet në masën **10.5 %**, pa llogaritur 5 subjekte të tjera që janë brenda afatit të kthimit të përgjigjes.

KLSH është e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve. Përgjatë vitit 2016, nga Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, janë trajtuar **45 letra** (ankesa) të ndryshme.

Krahas impenjimeve në auditim është ndjekur me përparësi programi i trajnimeve të organizuar nga Sektori i Trajnimeve në KLSH dhe jashtë saj. Realizuar gjithsej **652 dite trajnimi**, brenda dhe jashtë KLSH. Mesatarja e departamentit, **31 ditë trajnimi për auditues**.

Kontributi i audituesve të Departamentit në median e shkruar, **prezenca ishte me 13 artikuj** (7 auditues) përgjatë vitit 2016. Nuk ka qenë në nivelin e kërkuar prezenca e audituesve të Departamentit në shtypin e shkruar, por është për t'u përgëzuar iniciativa.

Pjesëmarrje në Konferencën e IV Shkencore të KLSH "Analiza e Riskut" me një punim me temë: *"Auditimi i të dhënave me kapacitet të lartë të sektorit publik sipas modelit Online"*.

Është organizuar 1 Workshop, gjatë Javës së Hapur për KLSH, më datë 3 Tetor 2016, në bashkëpunim me Organizatën "Albanian Platform for Policy and Advocacy (APPA)", ku u trajtua tema *"Prezantimi i gjetjeve nga monitorimi i Qeverisë për vitin 2016"*. Nga Departamenti ynë u prezantuan rezultatet e auditimit të Autoritetit Portual Durrës, ku gjatë këtij auditimi është bashkëpunuar me dy organizatat jofitimprurëse "Albanian Platform for Policy and Advocacy (APPA)" dhe organizata "Integritet Urban".

Aktiviteti vijoi me prezantimet e punës audituese të kryera në disa subjekte si: prezantimi i auditimit të kryer në shoqërinë Albpetrol SHA nga audituesi z. Artan Topjana; prezantimi i auditimit të kryer në Autoritetin Portual Durrës nga kryeaudituesi z. Fatmir Iljazi dhe audituesi z. Alfons Gabili; prezantimi i auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar për Projektin "Ndërtimi i By pass Fier dhe By Pass Vlorë" nga kryeaudituesja znj. Yllka Pulashi dhe audituesi z. Aldo Kume; prezantimi i auditimit të performancës "Problematika e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik" nga kryeaudituesi z. Gjovalin Preçi; si dhe prezantim i auditimit "Performanca e shoqërive publike për certifikimin financiar" nga audituesja znj. Ina Sokoli. Prezantimi i këtyre auditimeve u shoqërua me diskutime të shumta midis anëtarëve të stafit akademik dhe audituesve të departamentit.

Risi në zhvillimin e analizës vjetore të departamentit për vitin 2016, ishin dhe disa prezantime të botimeve të KLSH-së, si prezantimi i botimit "Auditim Publik 2012-2015" nga audituesit znj. Mimoza Bedini, z. Erion Muho, z. Dritan Kore dhe znj. Lili Dulo; prezantimi i botimit "Eksperiencia e vendeve Europiane në auditimin e jashtëm publik", nga audituesit znj. Nikoleta Piranjani, znj. Redina Karapici, z. Skënder Hajdari dhe z. Bledi Dervishaj; si dhe prezantimi i botimit "Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit European dhe e Këshillit të BE-së, e datës 26 shkurt 2014 "Mbi Prokurimin Publik" nga audituesja znj. Miranda Haxhia.

Më pas u vijua me prezantimin e rezultateve të Kontrollit të Cilësisë për auditimet e ushtruara gjatë vitit 2016, nga Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja si dhe Shoqërive Publike, prezantim i cili u krye nga audituesja znj. Jorida Zhegu, anëtare e grupit të Kontrollit të Cilësisë.

Në përfundim, drejtorja e departamentit znj. Albana Agolli, prezantoi objektivat e departamentit për vitin 2017, ku puna menaxheriale do të jetë në përputhje të plotë me objektivat e Planit të Zhvillimit Strategjik 2013-2017 të KLSH, të rishikuar për periudhën 2015-2017, për realizimin e objektivave të departamentit dhe të institucionit në drejtim të:

- Ndërtimit të kapaciteteve;
- Standardeve profesionale;
- Shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave;
- Menaxhimit në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe komunikimit efektiv.